



## Kuptimet e brendshme të pesë shtyllave të Islamit

### Description

Shah Vali Allah el-Dehlevi

*Kuptimet e brendshme të abdesit dhe larjes së plotë të trupit [gusl]*

Ti duhet ta dish se një njeri mund të rrëmbehet nga turbullirat e natyrës dhe të çohet në dritat e Arealit të Shenjtë, aq sa këto drita e dominojnë atë dhe, për një kohë, ai bëhet në njëfarë kuptimi i çlirët nga determinantët e natyrës. Kështu, ai dërgohet në grupin e tyre, dhe sa i përket zhveshjes së frymës më të ulët, personi bëhet sikur ai të ishte njëri prej tyre. Më pas, ai rikthehet në konditën e tij të mëparshme, por gjakon për atë çka përkon me gjendjen e mëparshme, për ta rrokur atë rishtazi mbasi e ka humbur, dhe për ta bërë atë një grackë për të rikapur atë çka i ka ikur nga nefsi. Ai gjen një gjendje që përshfaq këtë karakteristikë që është lumturia dhe kënaqësia e përftuar përmes të hequrit dorë nga ndytësia dhe duke përdorur gjëra që e dëlirësojnë, kështu që ai i adopton pa luhatje këto masa. [Në rang] atë e pason një person që ka dëgjuar informuesin e vërtetë tek thotë se kjo konditë është përsosmëria e njeriut, dhe se nëpërmjet saj ai kënaq Krijuesin e tij dhe se ka dobi të panumërta në të, kështu që ai e konfirmoi atë me dëshminë e zemrës së tij dhe bëri atë për të cilën u urdhërua, dhe zbuloi se ajo çka Pejgamberi kishte thënë në lidhje me të ishte e vërtetë. Dyert e rahmetit/mëshirës iu hapën atij dhe ai u bojatis me ngjyresën e ëngjëjve. Këtë e pason një njeri që nuk di asgjë nga këto, por pejgamberët e udhëzuan atë dhe e nxitën drejt qëndrimeve të cilat në amshim e vënë atë në një rrafsh përmes të cilit ai mund t'i bashkohet udhës së ëngjëjve; dhe këta janë njerëzit të cilët tërhiqen me zinxhirë për në Parajsë.<sup>[1]</sup>

Ndikimi i pastrimit ritual (abdes, gusul) ndihet menjëherë në nefsin (veten/frymën) më të ulët. Pjesësmë të madhe të njerëzve i duhet folur në lidhje me papastërtinë dhe kjo për shkak të natyrës së saktë të burimeve të saj të parashikuara, mbizotërimit të saj, dhe se lënia pas dore e mësimi në lidhje me tëdo të përbënte një dëm të madh për njerëzit.

Hulumtimi i papastërtisë rituale mund të reduktohet në dy lloje kryesore.

1) E para e këtyre llojeve është nefsi më i ulët që hutohet nga tre sende të tepërta që një person i ka në stomakun e tij: gazi, ujët e hollë, dhe ujët e trashë. Nuk ka person që nuk e di se kur ai ka gaz në stomakun e tij apo ka nevojë që të kryejë ujte e hollë apo të trashë, nefsi i tij më i ulët bëhet i dëmshme aq sa ai lidhet me tokën, dhe bëhet i hutuar dhe i hidhëruar, dhe ka një ledh midis tij dhe të qenit e tij të kënaqur. Më pas, kur ai eliminon gazrat dhe çlirohet, dhe përdor diçka si për të vënë në alarm nefsin e tij për t'u dëlirësuar, siç është larja e plotë e trupit apo abdesi, ai përjeton kënaqësi dhe lumturi dhe ndihet sikur të kishte gjetur rishtazi një gjendje që e kishte humbur.

2) E dyta është hutimi i nefsit më të ulët nga dëshira për raport seksual dhe kredhja e tij në epsh; sepse kjo e kthen krejtësisht aspektin e nefsit më të ulët në drejtimin e natyrës kafshërore. Kjo ndodh në një masë të atillë sa që edhe kafshët e zbutura, kur stërviten dhe mësohen me sjelljet e dëshiruara; dhe gjahtarët, kur ata bëhen të kontrolluar nga uria apo mungesa e gjumit dhe janë mësuar se si të bëjnë gjueti për zotërinë e tyre; dhe zogjtë, në qoftë se u kërkohet që të imitojnë ligjërimin e njerëzve – dhe përmbledhtazi çdo kafshë që ka bërë përpjekje të skajshme për të eliminuar prirjen e saj kah natyra fizike dhe në të përftuarit e asaj që natyra e saj fizike nuk e kërkon – kur ajo kafshë plotëson epshin e nxitjes së saj seksuale dhe zhytet në kënaqësi për ditë me radhë, ajo pashmangshmërisht harron atë që ka mësuar dhe rikthehet në marrëzi, injorancë, dhe kequdhëzim. Cilido që reflekton mbi këtë, pashmangshmërisht ka për të mësuar se plotësimi i epshit e ul nefsin më të ulët në një mënyrë më të fortë se sa çdo e ngrënë me tepri apo sipërmarrje e marrë dhe pjesa tjetër e atyre gjërave që e shtyjnë nefsin që të priret drejt natyrës kafshërore. Për ta testuar këtë për veten e tij, një person duhet t'i referohet asaj çka doktorët thonë në lidhje me regjimin për murgjërit e përkorë në qoftë se dëshirohet që ata të rikthehen në anën kafshërore.

Dëlirësia, apo pastërtia – efekti i së cilës perceptohet që me shikim të parë, dhe në lidhje me të cilën shumica e personave mund të adresohen siç duhet për shkak të mjeteve të bollshme në viset e populluara që gjenden për ta arritur atë, pra, nëpërmjet ujit dhe rregullimit të tij, që është agjenti më efikas dhe më dëlirësues për nefsin njerëzor dhe diçka e mirënjohur dhe e pranuar në gjirin e tyre në të qenit e tij shteg natyror – do të hulumtohet duke u përqendruar mbi dy tipe: pastërtia e vogël (abdesi) dhe pastërtia e madhe (gusuli)

Sa i përket pastrimit të madh, ai përbëhet nga larja dhe fërkimi i të gjithë trupit, duke qenë se uji është një element pastrues që eliminon papastërtitë kështu që falë kësaj prirjet natyrore bëhen të shëndetshme. Kësisoj, ai është mjeti i duhur për të njoftuar nefsin për tiparin e dëlirësisë. Ka njerëz që pijnë verë dhe pije dehëse, aq sa dehja ua kaplon natyrën e tyre fizike. Si rrjedhojë, ata kryejnë disa teprime si vrasja e pajustificuar apo shpërdorjnë pasurinë mbi sende mjaft të kushtueshme. Më pas, krejt befas, vetvetja e tij vjen në vete, reflekton, dhe e gjithë ndotja flaket tutje prej saj. Ka njerëz që

janë të dobët dhe nuk janë në gjendje të zgjohen nga një gjendje, dhe as të ndërmarrin asgjë; atëherë, ndodh një ngjarje që e zgjon fuqimisht vetveten, siç janë shfaqjet e zemërimit, pasionit, apo rivalitetit, kështu që ai mund të ndërmarrë një detyrë mjaft të vështirë, dhe madje edhe të shkaktojë gjakderdhje të rëndë.

Përmbledhtazi, vetvetja mund të përjetojë një tranzicion dhe zgjim të nxitur nga njëri tipar te një tipar tjetër që është baza e kurave psikologjike. Kjo gjendje e nxitur e zgjimit përftohet vetëm nëpërmjet asaj çka është e ngulitur vendosmërisht në thelbin e natyrave të tyre dhe rrënjën e veteve të tyre se kjo është dëlirësi e sakjshme, dhe se kjo mund të jetë vetëm ujë.

Abdesi është i kufizuar vetëm në larjen e gjymtyrëve dhe ekstremiteteve (fytyra, duart, dhe këmbët), dhe kjo është falë faktit se në në viset e buta këto janë zakonisht vendet që janë natyrshëm të ekspozuara dhe janë jashtë rrobave. Një aluzion u bë për këtë kur Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, e ndaloi mbështjelljen e gurëve të lëmuar<sup>[2]</sup> dhe nuk ka asnjë vështirësi në larjen e tyre ndërkohë që nuk është kështu me pjesën tjetër të gjymtyrëve të trupit. Krahas kësaj, zakoni i njerëzve të qytetëruar është që t'i lajnë ato çdo ditë, si dhe në rastet kur dalin përpara mbretërve dhe përfaqësuesve të tyre, dhe kur kanë për synim që të kryejnë veprime të pastra. Kuptimi që qëndron në themel të kësaj është se gjërat e ndotura prekin me shpejtësi të jashtmen dhe këto pjesë të jashtme të trupit janë të dukshme dhe bien në sy kur personat takohen me njëri tjetrin. Krahas kësaj, përvoja e ka vërtetuar se larja e ekstremiteteve dhe hedhja e ujit në fytyrë e në kokë e zgjon vetveten nga përgjumja dhe plogështia e thellë. Një person duhet t'i referohet përvojës dhe dijës së tij dhe asaj çka kanë urdhëruar doktorët në të trajtuarit e dikujt që humb ndjenjat apo i cili vuan nga pasojat e diarresë apo humbjes së tepërt të gjakut.

Pastërtia është njëra nga ndarjet e *Irtifak*-ut të Dytë mbi të cilin varet përsosmëria e njeriut, dhe ajo është bërë pjesë e prirjes së natyrshme të njerëzve. Ajo kryen një afrim me ëngjëjt, distancim nga djajtë, dhe mbron ndaj ndëshkimit të varrit. Sa më poshtë është ajo që ka thënë Pejgamberi: “Pastrojeni veten mbasi dilni për ujtë e hollë pasi përgjithësisht ndëshkimi i varrit ndodh për shkak të kësaj [papastërtie].”<sup>[3]</sup> Në [dëlirësim] ka një gjasë të madhe që nefsi të pranojë ngjyresën e ndershëmërisë. Kjo lihet të kuptohet në thënien e Zotit, i Lartësuar qoftë Ai, “Dhe Ai i do ata që ruajnë pastërtinë”.<sup>[4]</sup> Kur pastërtia rrënjësohet thellë në nefsi dhe e pushton atë, në të ka të konfirmuar një pjesë të dritës së ëngjëjve dhe se një pjesë e errësirës kafshërore është mposhtur. Ky është kuptimi i të shkruarit të veprave të mira dhe i faljes së gjynaheve.

Në qoftë se dëlirësia bëhet konvencion, ajo bën dobi kundër katastrofave të konvencioneve [të dobëta e të padobishme]. Në qoftë se ai që e zotëron atë i qëndron besnik qëndrimeve që njerëzit kanë kur hyjnë në prezencën e një mbreti, si dhe [i qëndron besnik] deklaratës shoqëruese të qëllimit dhe dhikreve që recitohen [në kohën e riteve të pastrimit], kjo bën dobi ndaj keqinterpretimit [rreth natyrës së Zotit].<sup>[5]</sup>

Kur një person kupton se kjo pastërti është përsosmëria e tij, ai i stërvit pjesët e trupit të tij në përputhje me këtë kuptim pa pasur asnjë motiv sensual. Krahas kësaj, dëlirësia bëhet një regjim për ta bërë anën fizike që të jetë e bindur ndaj intelektit – dhe Zoti e di më së miri.

## *Dimensionet e brendshme të namazit*

Ti duhet ta dish se një person mund të rrokot menjëherë nga Enklava e Shenjtë aq sa ai bëhet krejtësisht i lidhur me lavdinë e Zotit, qoftë Ai i Lartësuar. Atij i zbulohen prej Atje teofanitë e shenjta deri aty sa këto mbizotërojnë nefsën e tij më të ulët. Në këtë ngjarje, ai dëshmon gjëra që gjuha nuk arrin t'i përshkruajë dot. Më pas, ai rikthehet në gjendjen e tij të mëparshme dhe atë e pushton preokupimi, aq sa ai e kultivon veten me një gjendje që është më e afërta e gjendjeve të ulëta në përthithjen e nefsit [frymës] në gnozën e Krijuesit të tij. Ai e bën atë [gjendje] një grackë për të kapur atë çka nefsë ka humbur, dhe kjo gjendje është përnderim, përunjësi, dhe bashkëbisedim intim gjatë veprimeve dhe thënieve të ngulitura për këtë [qëllim]. Pas tij vjen ai njeri që ka dëgjuar bartësin e sinqertë të lajmit teksa e fton në këtë gjendje, dhe ai e dëshiron atë, dhe ai dëshmon me gjithë zemër për të dhe vepron në bazë të saj, dhe sheh se ajo çka i ishte premtuar në lidhje me të është e vërtetë dhe ai avancon drejt asaj që ai kishte shpresuar. Më pas, vjen një ai njeri të cilin profetët e nxitnin që të falte namazin, por ai nuk e kupton këtë, njëlloj si babai i cili i shtrëngon fëmijët e tij që të mësojnë zanate të dobishme ndonëse atyre nuk u pëlqen kjo gjë. Një njeri mund t'i lutet Zotit të tij për mbrojtje nga një gjëmë apo që të manifestojë një bekim, dhe sipas të gjitha gjasave në atë çast ai përthithet në akte dhe fjalë të mbarsura me përnderim, si për ta bërë efikase vendosmërinë e tij të përqendruar që është shpirti i kërkesës, dhe kjo është ajo çka u bë praktikë në namazin e shiut.<sup>[6]</sup>

Namazi është i bazuar në tre gjëra: 1) Se zemra është e përlur para vështrimit të shpejtë të Madhështisë së Allahut dhe Lartësisë së Tij; dhe 2) se gjuha e shpreh Lartësinë e Allahut dhe këtë përunjësi me shprehjen më të qartë. 3) Se gjymtyrët disiplinohen në bazë të kësaj përunjësie.

[Një poet ka dëshmuar se]

*Tri pjesë të trupit tim korrën dobi nga bereqeti Yt*

*Dora ime, gjuha ime dhe vetja ime subliminale.*

Ndër veprimet e përnderimit janë të qëndruarit përpara Tij, të besuarit e punëve Atij me anë të lutjeve intime, dhe të kthyerit e fytyrës kah Ai. Më e fortë se kjo është se njeriu është i vetëdijshtëm për të qenit e tij i ulët si dhe për rangun e lartë të Zotit të tij, kështu që ai i mban kryet ulur. Njerëzit dhe kafshët, nga i pari tek i fundit, kanë prirjen e natyrshme që të ngrejne qafën dhe kjo është një shenjë e mendjemadhësisë dhe krenarisë dhe ulja e kryeve është shenjë e nënshtrimit dhe përunjësisë, dhe kjo është thënia e Zotit, qoftë Ai i Lartësuar, "Qafët e tyre u përlulën përpara saj në përunjësi".<sup>[7]</sup>

Megjithatë, më e fortë se kjo është se njeriu e vë fytyrën e tij, që është më e fismja nga pjesët e trupit të tij dhe vendi ku takohen shqisat e tij, në dheun përpara Tij. Këto tre akte të përnderimit janë bërë të

përhapura në gjirin e grupeve të ndryshme të qenieve njerëzore të cilët i kryejnë ato pareshtur në namazet e tyre dhe përpara mbretërve dhe princëve. Forma më e shkëlqyer e namazit ndërthur tre pozicionet që avancojnë nga më e vogla deri tek më e madhja, në mënyrë që të zhvillohet progresivisht sensi i nënshtrimit dhe përunjësisë. Në këtë progresion ka një dobi që nuk gjendet në veprimet individuale të përndërimit, jo në rendin zbritës nga më e madhja deri tek më e vogla.

Kështu, namazi u bë themeli i veprimeve që e bëjnë një njeri t'i afrohet [Zotit], dhe jo një reflektim i madhështisë së Zotit apo përkujtimit të vazhdueshëm [*dhikr*] të Tij, për shkak se reflektimi i vërtetë dhe i shëndoshë arrihet vetëm nga një grup me nefse të larta e të zhvilluara, dhe sa pak janë të tillët. Përtej këtyre gjërave, nëse njerëzit bëhen të zhytur [në reflektim] ata do të bëheshin apatikë, dhe do të çonin dëm burimet e tyre, në vend se të përftonin dobi të tjera. Përkujtimi i Zotit, në mos i paraqitur dhe i përkrahur nga ndonjë akt i përndërimit i kryer nga gjymtyrët truporë që një person kryen rregullisht, rezulton në shqetësim pa dobi në rastin e pjesës më të madhe të njerëzve.

Sa i përket namazit, ai është një melhem shërues [*me'xhun*] i përbërë nga mendimi i drejtuar kah madhështia e Zotit si një qëllim i dytë, dhe vëmendshmëria pasuese që lind nga çdo person. Nuk ka asnjë kufizim mbi atë me kapacitet për të shkuar më thellë në oqeanin e të dëshmuarit; më saktë, kjo do të shërbejë për ta vënë atë në alarm në mënyrën më të plotë. Ndër gjërat që çojnë më qartësisht drejt kësaj janë të kushtuarit e veprimeve Zotit, të kthyerit e fytyrës kah Zoti, dhe të kufizuarit e çdonjërit prej kërkesave të tij për ndihmë vetëm te Zoti. Ndër aktet e përndërimit si sexhdeja [ulja e ballit në tokë] dhe rukuja [përkulja], çdonjëra mbështet dhe plotëson tjetrën dhe e vë atë në dijeni, kështu [namazi] i bën dobi si personit të zakonshëm ashtu dhe atij të jashtëzakonshëm, dhe është një antidot fuqimisht efikas, sepse ai ndikon tek çdonjëri në një mënyrë që i shkon për shtat natyrës themelore të kapacitetit të tij. "Namazi është shtegu i ngjitjes për besimtarin"<sup>[8]</sup> dhe një përgatitje për teofaninë e amëshimit, dhe kjo është thënia e tij, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, "Me të vërtetë ju do da shihni Zotin tuaj [në jetën tjetër], nëse jeni në gjendje që të mos mbaheni larg namazeve përpara lindjes dhe perëndimit, kështu që falini ato."<sup>[9]</sup> Kjo është një shkak i madh i dashurisë për Zotin dhe mëshirën e Tij, dhe kjo është thënia e tij, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, "Më ndihmoni të arrijë këtë për ju nëpërmjet sexhdeve të shumta"<sup>[10]</sup> dhe përshkrimi i Tij, qoftë Ai i Lartësuar, i shqiptimit të njerëzve të Zjarrit, "Ne nuk ishim ndër ata që falnin namazin".<sup>[11]</sup>

Kur namazi bëhet i konsoliduar nga ana e adhuruesit, ai shuhet në dritën e Zotit, dhe mëkatet e tij falen. "Veprat e mira çbëjnë veprat e këqija."<sup>[12]</sup>

Asgjë nuk i bën dobi problemit të keqinterpretimit [të njëshmërisë së Zotit] më tepër se sa namazi, sidomos në qoftë se veprimet dhe fjalët e tij kryhen nga zemra dhe me një qëllim të ndershëm. Në qoftë se namazi bëhet konvencion, ai do të ketë një efekt të qartë dobipurës kundër katastrofës së konvencioneve [të dobëta], dhe kjo gjendet në thënien e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, "Besëlidhja që është mes nesh e atyre është namazi, kështu që cilido që e braktis atë është bërë jobesimtar."<sup>[13]</sup> Nuk ka asgjë si namazi për stërvitjen e vetes së ulët që ta bëjë natyrën fizike t'i nënshtrohet arsyes dhe të ndjekë gjykimin e saj – dhe Zoti e di më së miri.

*Dimensionet e brendshme të Zekatit*

Ti duhet ta dish se kur një nevojë i paraqitet të skamurit, dhe ai i përgjërohet Zotit në lidhje me të qoftë me fjalë apo nëpërmjet konditës së tij, përgjërimit i tij troket në portën e Bujarisë Hyjnore. Ndonjëherë, interesi më i mirë do të përmbushet duke e frymëzuar zemrën e një personi të kulluar që të ofrojë mjetin e shërimit për mungesën që ai ka. Kësisoj, kur frymëzimi zbret dhe ai provokohet [që të reagojë], atij i jepet sukses. Zoti është i lumtur me Atë, dhe bekimet rrjedhin tek ai nga sipër dhe nga poshtë, dhe nga ana e tij e djathtë dhe nga ana e majtë, dhe mëshira e Zotit është mbi të.

Një ditë një person i varfër më pyeti në lidhje me një nevojë që ai e kishte me ngut dhe unë nuhata në zemrën time një frymëzim që më urdhëroi të jepja, dhe më njoftoi mua për një shpërblim të bollshëm në këtë botë dhe në tjetrën, kështu që unë dhashë dhe dëshmova se ajo çka Zoti im më kishte premtuar ishte e vërtetë. Trokitja në portën e Bujarisë [hyjnore], zgjimi i frymëzimit dhe përzgjedhja nga ana e saj e zemrës sime në atë ditë, dhe manifestimi i shpërblimit, të gjitha këto ndodhën përpara vetë syve të mi.

Ndonjëherë shpenzimi i parave është një burim i parashikuar i mëshirës hyjnore, si atëherë kur në gjirin e Kuvendit më të Naltë lind një motiv për ngritjen e një bashkësie kështu që çdokush që merr përsipër të kryejë urdhërin e tyre është i begatuar, dhe ndërmarra nga ana e një personi e një shpenzimi në atë kohë është i njëvlershëm me [pjesëmarrjen] në një ekspeditë të vështirë ushtarake. [14] Një tjetër shembull do të ishte një periudhë e thatësirës kur një bashkësi është ndër krijesat më nevojtare të Zotit, dhe ajo çka synohet është ringjallja e tyre.

Përmbledhtazi, bartësi i sinqertë i lajmeve bëri nga ky shembull i hamendësuar një rregull të përgjithshëm, duke thënë se cilido që jep bamirësi këtij e atij lloji të njeriut të varfër – apo në aksh e aksh situatë – Zoti do ta pranojë këtë veprim prej tij. Më pas, dikush e dëgjon këtë dhe i nënshtrohet gjykimit të saj me gjithë zemër, dhe zbulon se ajo çka ishte premtuar është e vërtetë.

Ndonjëherë vetja më e ulët kupton se dashuria për pasurinë dhe të qenit dorështrënguar me atë e dëmton një person dhe e largon atë nga kjo rrugë, kështu që ai vuan së tepërmi nga kjo. Personi nuk është në gjendje që ta pengojë këtë përveçse duke praktikuar dhënien e çfarëdolloj gjëje që ai ka më për zemër. Në rastin e tij, të dhënit është gjëja më dobiprurëse, sepse në qoftë se ai nuk jep, dashuria [për pasurinë] dhe kopracinë do të mbeten siç janë, dhe në Amëshim do të marrë formën e një gjarpëri pa qime [15] ose pasuria e tij do të marrë formën e diçkaje që e lëndon atë – dhe ky është hadithi, “Një rrafshinë e butë ranore do të hapet para syve të tyre,” [16] dhe thënia e Tij, qoftë Ai i Lartësuar, “dhe ata të cilët grumbullojnë ar e argjend” [17]

Ndonjëherë, koha e shkatërrimit të personit mund të ketë ardhur tashmë, dhe rrënimi i tij është dekretuar në Botën e Imazheve, atëherë ai vijon të shpenzojë pasuri të madhe, ndërkohë që ai dhe persona të tjerë të mirë përreth tij i luten Zotit. Në këtë mënyrë, ai anulon vetë shkatërrimin e tij nëpërmjet shkatërrimit të pasurisë së tij, dhe kjo është thënia e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, “Fatin pas nuk e kthen asgjë vetëm se namazi ku lutesh, dhe jetëgjatësinë nuk e shton asgjë vetëm se devotshmëria.” [18]

Ndonjëherë ndodh që një person bën një akt të lig për shkak se atë e kaplon natyra e tij fizike, dhe më pas bëhet i vetëdijshëm për neverinë që përmban ai akt dhe pendohet. Më pas, natyra fizike e pushton sërish dhe ai rikthehet tek ajo. Gjëja më e zgjuar për të bërë për të shëruar nefsin e tij është që ai të

këmbëngulë që ta harxhojë pasurinë e madhe për të ndrequr çfarëdolloj [padrejtësie] që ai bën kështu që kjo [humbje] ka për të ngelur në mendjen e tij, dhe ka për të zbrapsur atë nga [aktet e liga] që atij mund t'i vijë ndërmend të kryejë. Ndonjëherë, karakteri i mirë dhe ruajtja e sistemit të zgjeruar familjar konsiston në shpërndarjen e ushqimit, dhënien e përshëndetjeve të gjithëve dhe gjëra të ngjashme, dhe tipe të ndryshme të akteve të bamirësisë, dhe kjo urdhërohet dhe cilësohet se është një sadaka [dhuratë me vullnet të lirë]. Zekati shton begatitë, shuan mërinë [hyjnore] duke tërhequr rrëzëllimin e mëshirës [nga Zoti], zbraps atë ndëshkim të Amshimit që vjen nga kopracia, dhe nxit në mënyrë të favorshme përmendjen nga ana e Këshillit të Naltë i cili përmirëson gjërat mbi tokë në raport me këtë person – dhe Zoti e di më së miri.

### *Dimensionet e brendshme të agjërimit*

Ti duhet ta dish se ndonjëherë një person e kupton falë frymëzimit që Zoti i jep atij se forma e tij kafshërore fizike po e mban atë larg asaj që do të përbënte plotësim për të në terma të bindjes ndaj anës ëngjëllore. Si rrjedhojë, ai fillon të ushqejë neveri për anën kafshërore dhe orvatet që t'i japë dërrmën forcës së saj. Në realizimin e kësaj gjëje ai nuk gjen asgjë më të mirë që ta ndihmojë atë se sa uria, etja, lënia e kontakteve seksuale, dhe të praktikuarit e syçelësisë ndaj gjuhës, zemrës dhe gjymtyrëve të tij. Këmbëngulja në këtë është një melhem për sëmundjen e nefsit të tij. Pas tij, vjen ai njeri që e ka mësuar këtë nga bartësi i sinqertë i lajmit [Pejgamberi Muhamed] me dëshminë e zemrës së tij, më pas vjen ai të cilin profetët e udhëzuan për shkak preokupimit që kishin për të, ndërkohë që ai vetë nuk e kuptoi këtë punë, kështu që ai fiton dobinë e kësaj në jetën tjetër përmes thyerjes së formës [kafshërore].

Ndonjëherë, një person bëhet i vetëdijshëm se kur e shtrëngon natyrën fizike që t'i bindet intelektit, kjo është përsomëria e tij – ndërkohë që natyra fizike është e pashtuar, herë bindet e herë të tjera nuk bindet. Kësodore, ai ka nevojë për përgatitje, kështu që ai i hyn një praktike të ashpër siç është agjërimi dhe ia imponon atë anës së tij fizike dhe këmbëngulë gjithnjë e më tepër në të qëndruarit besnik ndaj zotimit të tij, derisa ai arrin objektivin e dëshiruar.

Ndonjëherë, ai kryen një mëkat, kështu që ai këmbëngulë duke agjëruar për ditë të shumta duke e ndryshur vetën e tij në reagim ndaj mëkatit, në mënyrë që ta pengojë veten nga rënia në mëkate të tjera.

Ndonjëherë, nefsi i tij më i ulët ka dëshirë për gra, por ai e ka të pamundur të martohet dhe druan se mund të bjerë në kurvëri, kështu që ai e mposht eposhin e tij nëpërmjet agjërimit dhe kjo gjendet në thënien e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, “Agjërimi e ndrydh dëshirën seksuale”.

[19]

Agjërimi është një vepër e madhe dhe e mirë që forcon ëngjëlloren dhe dobëson kafshëroren. Agjërimi nuk ka të dytë në të dëlirësuarit e fytyrës së shpirtit dhe në të nënshtruarit e natyrës fizike. Si rrjedhojë, Zoti, i lartësuar qoftë Ai, ka thënë: “Agjërimi është vetëm për Mua dhe Unë e shpërblejë atë.” [20] Gjynahet e njeriut falen në masën që forma kafshërore pakësohet dhe nëpërmjet kësaj arrihet një

ngjashmëri e madhe me ëngjëjt, kështu që ata e duan atë. Atashimi i dashurisë ndihmon efektin e dobësimin të anës kafshërore dhe kjo gjendet në thënien e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, “Fryma e rëndë e agjëruesit është më e ëmbël te Zoti se sa erëtimi i miskut.”[\[21\]](#) Në qoftë se bëhet një konvencion i zakonshëm, [agjërimi] bën dobi kundër dëmeve të konvencioneve [të mangëta]. Në qoftë se një bashkësi këmbëngulë në agjërim, djajtë e tyre lidhen me zinxhirë dhe portat e kopshtijeve të Xhenetit hapen katërsh për ta, dhe portat e zjarreve të Xhehenemit mbyllen për ta.[\[22\]](#)

Kur një person bën orvatje që ta nënshtrojë nefsën e tij të ulët dhe të eliminojë cilësitë e tij të këqija, akti i tij do të marrë një formë të shenjtëruar në Botën e Imazheve. Ndër më të kulluarit e gnostikëve (arifin) është ai që përqendrohet mbi këtë formë, pasi ai pajiset me dije nga Bota e Padukshme dhe arrin bashkim me Esencën Hyjnore si pasojë e transhendencës dhe shenjtërimit. Ky është kuptimi i thënies së Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, që i atribuon Zotit fjalë: “Agjërimi bëhet vetëm për Mua dhe Unë e shpërblej atë”.[\[23\]](#)

Ndonjëherë një njeri fillon të kuptojë dëmin që bart të qenit i shqetësuar me punët e kësaj dynjaje dhe me mbushjen e shqisave me stimuj të jashtëm. Kjo ndihmohet nga të kushtuarit e vetes ndaj adhurimit [\[24\]](#) në një xhami të projektuar për namaze, kështu që ai të mos e ketë të mundur që të këmbëngulë në atë [preokupim]. Edhe sikur ai të mos e përmbushë plotësisht këtë veçim të tijin, ai nuk duhet të heqë dorë prej tij në tërësi. Kështu, ai merr mundësitë nga situata e tij dhe veçohet në një xhami për aq kohë sa ç’është e shkruar për të. Pas tij vjen ai person i cili me gjithë zemër e pranon këtë nga prurësi i sigurtë i lajmeve [Pejgamberi], dhe [pas këtij të fundit] vjen personi i zakonshëm i cili mposhtet, siç është përmendur më sipër.

Ndonjëherë një person mund të agjërojë por nuk është në gjendje të pastrojë gjuhën e tij vetëm se nëpërmjet veçimit në xhami. Ndonjëherë ai mund të bëjë një dua në Natën e Kadrit,[\[25\]](#) dhe të kërkojë një lidhje me ëngjëjt, dhe ky kontakt nuk është i mundur vetëm se duke u veçuar në *itikaf* në xhami. Ty do të jepet, kështu, kuptimi i Natës së Kadrit – dhe Zoti e di më së miri.

### *Dimensionet e brendshme të Haxhit*

Ti duhet ta dish se natyra e vërtetë e Haxhit është grumbullimi i një grupi të madh të njerëzve punëdrejtë në një kohë që përkujton të begatuarit ndër pejgamberët, të sigurtët [*siddikin*], dëshmorët, dhe punëdrejtët, dhe kjo në një vend “në të cilin ka shenja të qarta” [të Zotit] që grupet e parisë së fesë e kanë vizituar, në përnderim të emblemave të Zotit; duke u përgjyruar, duke gjakuar dhe shpresëplotë për të mirën dhe për faljen e gjynaheve nga Zoti. Sepse në qoftë se vendosmëria e përqendruar fokusohet në këtë mënyrë, zbritja e mëshirës dhe e faljes nuk do të mënojë të vijë. Dhe kjo gjendet në thënien e Profetit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, “Shejtani nuk ka përjetuar ditë në të cilën ai të jetë më i papërfillshëm, më i refuzuar, më i poshtëruar dhe më i inatosur se sa në Ditën e Arafatit.”[\[26\]](#)

Baza e haxhit (pelegrinazhit) është e pranishme në çdo bashkësi, pasi pashmangshmërisht ata kanë një vend në të cilin ata luten për bekim duke qenë se ata kanë parë manifestimin e shenjave të Zotit në

atë vend, dhe kanë kurbanet dhe format e tyre rituale të kaluara dorë më dorë nga paraardhësit e tyre në të cilat ato këmbëngulin për shkak se ato janë një përkujtues i atyre që iu afruan Zotit dhe të asaj çfarë ata bënin.

[Vendi] më i denjë ku kryhet haxhi është shtëpia e Zotit [Qabeja], “në të cilën ka shenja të qarta [të Zotit].” Ibrahim, paqja e Zotit qoftë mbi të, mirësia e të cilit është e dëshmuar nga pjesa më e madhe e kombeve, e ndërtoi atë me urdhër të Zotit dhe me shpalljen e Tij, mbasi toka [atje] kishte qenë e shkretuar dhe e pashkelur. Pelegrinazhet e ndërmarra në vende të tjera përfshijnë ose shirk [ortakëri] ose disa bidate [risi] të pabaza.

Nga aspekti i dëlirësisë së nefsit, shkuarja për vizitë në një vend që punëdrejtët nuk reshtin së lartësuar dhe së vizituari, dhe të cilin ata e mbushin me përkujtimin e Zotit, tërheqë atashimin [e një person] të vendosmërisë së përqendruar të ëngjëjve më të ulët dhe anon me simpati drejt tij evokimin universal të Kuvendit më të Naltë për njerëzit e të mirës. Kësisoj, në qoftë se ai qëndron atje, ngjyresat e tyre zënë e mbizotërojnë nefsën e tij, dhe këtë unë e kam parë me vetë sytë e mi.

Nën temën e përkujtimit të Zotit, i lartësuar qoftë Ai, vjen të vështruarit e emblemave të Zotit dhe të pasurit e nderimit për to. Kur ato shihen, njeriu përkujton Zotin, pikërisht sikurse të shikuarit e diçkaje sjell ndërmend çfarëdo që është e lidhur me të. Kjo është veçanërisht dominuese kur njeriu i përmbahet me besnikëri qëndrimeve të pënderimit, vetëpërmbajtjes, dhe rregullave e caqeve që vënë fuqimisht në alarm nefsën. Ndonjëherë një person është mjaft i tërhequr drejt Zotit të tij, kështu që ai ka nevojë për diçka nëpërmjet së cilës të kënaqë këtë gjakim, dhe kjo nuk mund të bëhet vetëm se nëpërmjet haxhit.

Pikërisht sikurse autoriteti sundues ka nevojë për një test mbas çdo periudhe kohore nëpërmjet së cilës të dallojë këshilltarin e sinqertë nga mashtruesin dhe të bindurin nga të pabindurin, dhe të ngrejë reputacionin e tij, të promovojë fjalët e tij, dhe të lërë popullin e tij që të vihen në dijeni për njëri tjetrin, po në këtë mënyrë feja ka nevojë për pelegrinazhin e Haxhit që të dallojë të sinqertin nga hipokriti, që të tregojë se njerëzit kanë hyrë në fenë e Zotit në turma, dhe që ata të mund të shohin njëri tjetrin dhe që çdokush të mund të përfitojë atë çka nuk e kishte pasur më parë, duke qenë se objektivat arrihen duke u mpleksur dhe duke parë njëri tjetrin.

Duke qenë se Haxhi është bërë një konvencion i mirënjohur, ai ndihmon [në heqjen e] dëmeve të konvencioneve [të rreme] dhe asgjë nuk është si ai që t’u përkujtojë [njerëzve] konditën e udhëheqësve themeltarë të fesë dhe që t’i nxisë ata që të jenë të paluhatur [në fe].

Duke qenë se Haxhi është një shtegtim në largësi si dhe një sipërmarrje e vështirë që realizohet vetëm nëpërmjet përpjekjes së fuqishme individuale, dhe kryerja e të cilit i kushtohet vetëm Zotit, Haxhi bën që gjynahet të falen dhe fshin atë që ka qenë më përpara, njëlloj siç ndodh në rastin e [pranimit për herë të parë të] besimit.[\[27\]](#)

Përktheu: Arjol Guni

## Referenca

- [1] Ndoshta një jehonë e haditheve që përmendin se disa njerëz do të hyjnë në Xhenet me zinxhirë. Këta ishin robërit e hershëm të luftës të cilët pranuan Islamin si robër. *Mishkat*, fq. 840. Buhariu, Xhihad, 144.
- [2] Ai ndaloi që një njeri të veshë petkën e tij dhe të mos lërë asnjë anë të saj të ngritur dhe të mbyllë çdo të hapur për dorën dhe këmbën e tij, duke ia përngjasuar këtë shkëmbinjve të mprehtë që nuk kanë asnjë zgavër apo të çarë. Buhariu Salat 10, Meuakit 40, Saum, 66, Libas 20, 21.
- [3] Ibn Maxheh Tahara 26, Ibn Hanbeli në disa variante.
- [4] Kuran 2:222.
- [5] E treta e perdeve që përmenden në Kapitullin e 34-t.
- [6] Ky namaz përshkruhet në përmbledhjet e hadithit, për shembull përkthimi nga ana i Khan i Buhariut II: 63-82.
- [7] Kuran 26:4.
- [8] Një hadith sufi që nuk gjendet në përmbledhjet standarte të haditheve të dobëta dhe të trilluara. Mejbudiu, *Keshf el-Esrar*, II:676.
- [9] Cituar më herët në parathënie. Buhariu, Mevakit 16, Teuhid 24, Muslimi, Ibn Maxheh, Ibn Hanbeli. Gjendet në përkthimin e Siddiqi të *Sahihut të Muslimit*, 1:307.
- [10] Kur Rabia ibn Kelb (63 A.H.) e pyeti Pejgamberin në qoftë se ai mund të ishte Bashkëshoqëruesi i tij në Xhenet, ai u përgjigj: “Atëherë më ndihmo që të arrijë këtë për ty nëpërmjet [kryerjes së] sexhdeve të shumta [në namaz].” Muslimi, Salat 224, 225. Përkth. 11:256.
- [11] Kuran 74: 43.
- [12] Kuran 11:114.
- [13] *Mishkat*, fq. 115. Tirmidhiu IV: 126 nr. 2756 Iman 9, Nesaiu, Ibn Maxheh, Ibn Hanbeli.
- [14] Në arabisht “*ghazuet el-‘usre*”, që është emri që i është vënë një ekspedite të kryer nga Profeti ndaj Tebukut në kushte të nxehta dhe të vështira.
- [15] *Mishkat*, fq. 376. Buhariu, Zekati 3, Tefsiri 3, 14, Nesaiu, Ibn Maxheh, Muvata’, Ibn hanbeli.
- [16] Ky është një hadith që në Ditën e Gjykimit ato turma të deveve, deleve, dhe dhive për të cilat një person nuk ka paguar zekat do ta nëpërkëmbin atë në një pllajë të sheshtë. *Mishkat*, fq. 371-372. Muslimi, Zekati, 24,26,27,28. Ebu Davudi, Nesaiu, Darimiu, Ibn Hanbeli.

[17] Kuran 9:34 -... “dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut, jepuni atyre lajmin për një dënim të dhimbshëm. Në atë ditë do të nxehet në zjarrin e Ferrit dhe ballët e tyre dhe ijet e tyre dhe shpinat e tyre do të damkosen aty.”

[18] Ibn Hanbel V: 277, 280, 282.

[19] *Mishkat*, fq. 658. Buhariu, Saum 10, Nikah, 2,3, Ibn Maxheh, Nesaiu, Ibn Maxheh, Darimiu, Ibn Hanbeli. “Ata që nuk kanë mundësi të martohen, duhet të agjërojnë, duke qenë se agjërimi ndrydh dëshirën seksuale.” Literalisht, agjërimi është një lloj tredhje për të.

[20] Hadith kudsî, thënie e Zotit. *Mishkat*, fq. 417. Buhariu, Saum 2, Teuhid 35, 50, Libas 78, Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxheh, Darimiu, Muvata‘, Ibn Hanbeli.

[21] *Mishkat*, fq. 417. Buhariu, Saum 2, Teuhid 35, 50, Libas 78, Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxheh, Darimiu, Muvata‘, Ibn Hanbeli.

[22] Bazuar mbi një hadith. *Mishkat*, fq. 417. Buhariu, Saum 2, Teuhid 35, 50, Libas 78, Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxheh, Darimiu, Muvata‘, Ibn Hanbeli.

[23] Një hadith kudsî. *Mishkat*, fq. 417. Buhariu, Saum 2, Teuhid 35, 50, Libas 78, Muslimi, Nesaiu, Ibn Maxheh, Darimiu, Muvata‘, Ibn Hanbeli.

[24] Kjo i referohet praktikës së “*itikaf-it*” apo kryerjes së një veçimi në xhami.

[25] Nata e Kadrit (*lejlet el-kader*). Një natë në dhjetë ditët e fundit të Ramazanit. Pejgamberi kryente një veçim në xhami në këtë kohë. Besohet se ëngjëjt zbresin në Natën e Kadrit, dhe se duatë marrin përgjigje.

[26] *Mishkat*, fq. 557. *Ihja’ ‘Ulum al-Din* në kapitullin e vrityteve të Haxhit.

[27] Pra, kur një person pranon Islamin, mëkatet e mëparshme fallen dhe, në mënyrë të ngjashme, kryerja e Haxhit fshin gjynahet e mëparshme.

#### **Date Created**

03/05/2021

#### **Author**

erasmusi